

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Largimi, asgjësimi dhe pastrimi i hapësirës nga materiet që përmbajnë azbest në TCB**

Sa i përket tenderit për **2026/KEK-26-5875-2-2-1/B05-0014825**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Intercert LLC, Prishtine

10 000, Prishtine, Kosove

Tel +383 48599330

Kreshnik Hoxha

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

E-mail: intercertllc@gmail.com

31.07.2026


(Nënshkrimi dhe vula)



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi per kontrate publikuar me date 20.07.2026
Afati i dorezimit te tendereve 29.07.2026
Data e hapjes se tenderve 29.07.2026
Kerkesa per sqarime shtese/korigjim te kriterëve – 20.07.2026
Refuzimi i kerkeses – 20.07.2026
Kerkesa per Rishqyrtim 22.07.2026
Vendimi i AK mbi refuzimin e Kerkeses per rishqyrtim 23.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

Ankesa nderlidhet me kriteret e perzgjedhjes, respektivisht me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, Operatori Ekonomik paraqet këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e paraqitur më datë 22.07.2026, lidhur me kriterin e kualifikimit teknik dhe profesional të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP - Qëllimi

Neni 7 i LPP – Barazia në Trajtim / Mosdiskriminimi

Neni 44 i LPP - Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose 42 Kërkesave për Pjesëmarrje

Neni 51 i LPP - Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Neni 69 i LPP - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, Operatori Ekonomik paraqet këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e paraqitur më datë 22.07.2026, lidhur me kriterin e kualifikimit teknik dhe profesional të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Kronologjia:

AK me date 20.07.2026 ka publikuar Njoftimin per kontrate per aktivitetin e prokurimit "Largimi, asgjësimi dhe pastrimi i hapësirës nga materiet që përmbajnë azbest në TCB". Kjo kërkesë për rishqyrtim paraqitet kundër Dosjes së Tenderit të publikuar më 20.07.2026 si dhe kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës sonë për korrigjimin e kriterit të kualifikimit teknik dhe profesional.

Kërkesa e percaktuar në FTD Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 është:

1. Licence apo pëlqim.

Deshmia:

1.Licencë apo pëlqim nga Ministria e Planifikimit Hapsinor për trajtimin e azbestit.

Pas publikimit të Dosjes së Tenderit, ne kemi paraqitur kërkesë për korrigjim të këtij kriteri, duke argumentuar se:

- ministria kompetente nuk lëshon licenca apo pëlqime për operatorët ekonomikë për trajtimin apo largimin e azbestit;*
- rrjedhimisht kriteri është objektivisht i pamundur të përmbushet nga çdo operator ekonomik.*

Shkresa drejtuar Autoritetit Kontraktues.

"Në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet e tij, kërkojmë sqarim dhe njëkohësisht rishqyrtim të Kriterit të kualifikimit teknik të percaktuar në Dosjen e Tenderit, sipas të cilit operatori ekonomik duhet të posedojë "licencë ose pëlqim nga Ministria për largimin/trajtimin e azbestit." Ky kriter nuk është i zbatueshëm në praktikë, pasi në Republikën e Kosovës ende nuk ekziston një rregullativë ligjore që rregullon licencimin ose dhënien e pëlqimit për operatorët ekonomikë për largimin apo trajtimin e materialeve që përmbajnë azbest. Për rrjedhojë, nuk ekziston procedurë administrative dhe as bazë ligjore për lëshimin e një licence apo pëlqimi të tillë nga autoriteti Kompetent. Vendosija e një kriteri që nuk mbështetet në legjislacionin në fuqi dhe që objektivisht nuk mund të përmbushet nga operatorët ekonomikë, kufizon konkurrencën, cenon parimin e proporcionalitetit dhe trajtimin të barabartë të operatorëve ekonomikë, si dhe bie ndesh me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik. Aktualisht, mekanizmi i vetëm zyrtar dhe i rregulluar në Republikën e Kosovës për garantimin e kompetencës profesionale në këtë fushë janë Institucionet e Akredituara në Republikën e Kosovës, dhe jasht saj, për ofrimin e programeve të trajnimit dhe certifikimit profesional të personelit që lëvojnë punë me azbest dhe materiale me përmbajtje azbesti. Për rrjedhojë, kompetenca profesionale në këtë fushë dëshmohet përmes personelit të certifikuar nga një institucion i akredituar, që tashmë ekziston në vendin tonë. Duke pasur parasysh sa më sipër, kërkojmë që kriteri: "Operatori Ekonomik duhet të posedojë licencë ose pëlqim nga Ministria për largimin/trajtimin e azbestit." të hiqet nga Dosja e Tenderit dhe të zëvendësohet me kriterin si vijon: "Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon personel të certifikuar për trajtimin e azbestit dhe materialeve me përmbajtje azbesti, të pajisur me certifikata të lëshuara nga një institucion i akredituar në Republikën e Kosovës. Ky kriter është në përputhje me standartet profesionale dhe kuadrin në Republikën e Kosovës, i cili garanton kompetencën profesionale të personelit që do të angazhohet në realizimin e kontratës, siguron mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe mundëson zhvillimin e një procedure të prokurimit në përputhje me parimet e konkurrencës së drejtë, proporcionalitetit dhe trajtimin të barabartë të operatorëve ekonomikë. Gjithashtu, rikujtojmë se edhe në raste të mëparshme të aktiviteteve të ngjashme

të prokurimit, organet kompetente të shqyrtimit kanë vlerësuar se kërkesat për dokumente të cilat nuk parashihen nga legjislacioni në fuqi nuk mund të përdoren si kriterë kualifikimi, pasi ato krijojnë pengesa të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë. Duke u bazuar në argumentet e mësipërme, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishikojë këtë kriter dhe të bëjë ndryshimet përkatëse në Dosjen e Tenderit, në mënyrë që procedura të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me parimet themelore të prokurimit publik”.

Pra, kemi propozuar zëvendësimin e këtij kriteri me një kërkesë që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponimin e personelit të certifikuar për trajtimin e azbestit, të pajisur me certifikata të lëshuara nga institucione të akredituara.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën, duke arsyetuar se kriteri është proporcional dhe bazohet në standardet e Bashkimit Evropian.

Citat nga pergjigjia e AK ... “Lidhur me aktivitetin e prokurimit “Largimi, asgjësimi dhe pastrimi i hapësirës nga materiet që përmbajnë azbest në TCB”, sa i përket kërkesës për rishikimin e kriterit “Licencë ose pëlqim nga Ministria për largimin/trajtimin e azbestit”, Autoriteti Kontraktues nuk e aprovon kërkesën tuaj, pasi vlerëson se ky kriter është i arsyeshëm, proporcional me natyrën e kontratës dhe i vendosur në përputhje me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian që rregullojnë trajtimin, largimin dhe menaxhimin e materialeve që përmbajnë azbest”.

Në kërkesën për rishqyrtim, të datës 22.07.2026, ne kemi argumentuar se ky kriter është objektivisht i pamundur për t’u përmbushur, pasi në Republikën e Kosovës nuk ekziston një bazë ligjore që përcakton procedurën e licencimit ose dhënies së pëlqimit nga Ministria kompetente për operatorët ekonomikë që kryejnë largimin, trajtimin apo menaxhimin e materialeve që përmbajnë azbest. Për rrjedhojë, kërkesa për posedimin e një licence apo pëlqimi të tillë krijon një pengesë të pajustificuar për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, pasi kërkon një dokument administrativ i cili nuk lëshohet nga asnjë institucion kompetent në Republikën e Kosovës.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues, me Vendimin e datës 23.07.2026, ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim, duke mos ofruar asnjë bazë ligjore konkrete që justifikon ekzistencën e një licence apo pëlqimi të tillë, por duke u kufizuar vetëm në një referim të përgjithshëm ndaj standardeve dhe kërkesave të Bashkimit Evropian duke deklaruar:

Citat nga Vendimi i AK “Autoriteti Kontraktues nuk e aprovon kërkesën tuaj, pasi vlerëson se ky kriter është i arsyeshëm, proporcional me natyrën e kontratës dhe i vendosur në përputhje me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian që rregullojnë trajtimin, largimin dhe menaxhimin e materialeve që përmbajnë azbest.”

Është e rëndësishme të theksohet se vetë arsyetimi i Autoritetit Kontraktues konfirmon në mënyrë të tërthortë faktin se nuk ekziston një bazë ligjore vendore për lëshimin e një licence apo pëlqimi të tillë. Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar asnjë dispozitë të Ligjit, akt nënligjor, procedurë administrative apo institucion kompetent në Republikën e Kosovës që ka autorizim për lëshimin e kësaj licence. Prandaj, referimi në standardet e Bashkimit Evropian nuk mund të zëvendësojë mungesën e një baze ligjore vendore dhe nuk mund të krijojë një kërkesë administrative e cila nuk ekziston në

Arsyetimi i ankesës

Ne konsiderojmë se arsyetimi i Autoritetit Kontraktues është i pabazuar dhe nuk adreson çështjen kryesore të ngritur në kërkesën për rishqyrtim.

Çështja nuk është nëse trajtimi i azbestit kërkon standarde të larta profesionale dhe masa të veçanta të sigurisë, pasi kjo nuk kontestohet. Përkundrazi, Operatori Ekonomik pajtohet se për punët që përfshijnë largimin dhe trajtimin e azbestit duhet të sigurohet që operatorët ekonomikë të kenë kapacitete profesionale, staf të trajnuar, pajisje adekuate dhe procedura të sigurta pune.

Çështja kryesore është se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një dokument administrativ – licencë ose pëlqim nga Ministria – i cili nuk ekziston në sistemin juridik dhe institucional të Republikës së Kosovës.

Autoriteti Kontraktues, duke refuzuar kërkesën për korrigjimin e kriterit, në fakt ka pranuar se nuk ka paraqitur asnjë bazë ligjore konkrete për ekzistencën e një licence të tillë, por është mbështetur vetëm në një referencë të përgjithshme ndaj **“standardeve dhe kërkesave të Bashkimit Evropian”**.

Një referim i tillë nuk mund të konsiderohet arsyetim i mjaftueshëm për vendosjen e një kriteri kualifikimi që nuk mund të përmbushet nga operatorët ekonomikë në Republikën e Kosovës.

Standardet e Bashkimit Evropian në fushën e azbestit kanë për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, menaxhimin e rrezikut dhe garantimin e kompetencës profesionale të personave që kryejnë këto punë. Megjithatë, këto standarde nuk nënkuptojnë automatikisht se çdo shtet duhet të ketë një mekanizëm specifik licencimi nga një ministri për operatorët ekonomikë. Përkundrazi, këto standarde kërkojnë që operatorët të kenë kompetencë reale profesionale dhe masa të përshtatshme kontrolli, jo domosdoshmërisht posedimin e një dokumenti administrativ të krijuar nga një autoritet kombëtar, nëse një mekanizëm i tillë nuk ekziston në legjislacionin vendor. Nëse në disa shtete anëtare të Bashkimit Evropian ekzistojnë skema të veçanta licencimi, ato janë rezultat i legjislacionit kombëtar të atyre shteteve. Në Republikën e Kosovës, një mekanizëm i tillë nuk është krijuar me legjislacion vendor.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues nuk mund të përdorë standardet e BE-së si bazë për krijimin e një kërke administrative që nuk ekziston në kuadrin ligjor vendor.

Për më tepër, duke refuzuar kërkesën për korrigjim, Autoriteti Kontraktues ka pranuar në mënyrë të tërthortë se kërkesa nuk lidhet me një dokument që mund të sigurohet nga operatorët ekonomikë në Kosovë, pasi nuk ka paraqitur asnjë institucion, procedurë apo dispozitë ligjore që mundëson lëshimin e kësaj licence.

Një kriter i tillë nuk garanton konkurrencë ndërmjet operatorëve ekonomikë, por përkundrazi eliminon paraprakisht të gjithë operatorët të cilët, edhe pse mund të kenë kapacitet profesional, staf të certifikuar dhe përvojë relevante, nuk mund të paraqesin një dokument që

nuk lëshohet nga asnjë autoritet kompetent.

Koniderojme se AK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-se si më poshtë.

1. Shkelja e nenit 7 të LPP-së

Neni 7 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues të sigurojë:

- trajtim të barabartë;
- mosdiskriminim;
- konkurrencë efektive ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 7 të LPP-së, pasi ka vendosur një kriter kualifikimi i cili objektivisht nuk mund të përmbushet nga operatorët ekonomikë, duke kërkuar posedimin e një licence/pëlqimi që nuk parashihet nga legjislacioni në fuqi dhe nuk lëshohet nga asnjë autoritet kompetent në Republikën e Kosovës. Ky kriter kufizon konkurrencën dhe cenon trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

2. Shkelja e nenit 51 të LPP-së

Sipas nenit 51 të LPP-së, kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë:

- të lidhura me objektin e kontratës;
- proporcionale;
- objektive;
- të verifikueshme.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të kërkojë një dokument administrativ **që nuk ekziston dhe që nuk mund të sigurohet nga operatorët ekonomikë.** Proporcionaliteti nuk vlerësohet vetëm nga rëndësia e objektit të kontratës, por edhe nga mundësia reale e operatorëve ekonomikë për ta përmbushur, kriterin. Në rastin konkret, kriteri është juridikisht dhe praktikisht i pazbatueshëm. Pra, Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 51 të LPP-së, pasi ka përcaktuar një kërkesë për kapacitet teknik/profesional e cila nuk është proporcionale dhe nuk mund të përmbushet në praktikë, për shkak se dokumenti i kërkuar nuk ekziston në kuadrin ligjor dhe institucional të Republikës së Kosovës.

3. Mungesa e bazës ligjore

Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar asnjë dispozitë ligjore në Republikën e Kosovës që:

- parashikon licencimin e operatorëve ekonomikë për trajtimin e azbestit;
- autorizon ministrinë kompetente të lëshojë licenca ose pëlqime të tilla.

Në mungesë të një baze ligjore, kerkimi i një dokumenti administrativ që nuk ekziston përbën shkelje të parimit të ligjshmërisë dhe krijon një kriter të pamundur për t'u përmbushur.

4. Lidhur me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues për referimin në standardet e

Bashkimit Evropian

Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen e tij ndaj kërkesës për rishqyrtim, ka arsyetuar se kriteri për posedimin e "Licencës apo pëlqimit nga Ministria për trajtimin e azbestit" **është vendosur në përputhje me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian.**

Ky arsyetim është i pabazuar dhe nuk mund të shërbejë si justifikim për vendosjen e një kriteri administrativ të cilin **sistemi juridik i Republikës së Kosovës nuk e njeh** dhe për të cilin nuk ekziston asnjë autoritet kompetent që lëshon një licencë apo pëlqim të tillë.

Standardet dhe praktikët e Bashkimit Evropian lidhur me menaxhimin e materialeve që përmbajnë azbest synojnë garantimin e sigurisë, mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve dhe mjedisit, përmes kërkesave për trajnim, kompetencë profesionale, procedura të sigurtë të punës dhe menaxhim të përshtatshëm të mbetjeve. **Ato nuk nënkuptojnë automatikisht ekzistencën e një licence kombëtare specifike, veçanërisht në një vend ku një mekanizëm i tillë licencimi nuk është krijuar me legjislacion vendor.**

Nëse qëllimi i Autoritetit Kontraktues ka qenë siguri i kompetencës profesionale për kryerjen e punëve me azbest, ekzistojnë mjete më proporcionale dhe të zbatueshme, si kërkesa për personel të trajnuar dhe të certifikuar, pajisje adekuate, metoda të punës dhe dëshmi për përvojën relevante.

Prandaj, referimi i përgjithshëm në standardet e Bashkimit Evropian nuk e arsyeton vendosjen e një kriteri të pamundur për t'u përmbushur dhe nuk mund të **mbizoterojë mbi parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, veçanërisht parimin e proporcionalitetit, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.**

Për më tepër, fakti që një kërkesë e tillë mund të ekzistojë në disa juridiksione të **Bashkimit Evropian nuk e autorizon Autoritetin Kontraktues që të imponojë një kërkesë administrative që nuk është krijuar dhe rregulluar me legjislacionin vendor.** Autoriteti Kontraktues duhet të sigurojë përputhjen me standardet profesionale, por brenda kornizës ligjore të zbatueshme në Republikën

Në këtë rast, qëllimi i Autoritetit Kontraktues për të garantuar sigurinë gjatë punëve me azbest është i ligjshëm dhe i arsyeshëm, mirëpo mënyra e zgjedhur për arritjen e këtij qëllimi nuk është proporcionale, pasi eliminon operatorët ekonomikë për shkak të mungesës së një licence që nuk ekziston. Kërkesat e prokurimit duhet të matin aftësinë reale të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës dhe jo posedimin e dokumenteve administrative të pamundura për t'u siguruar.

Në këtë rast, qëllimi i Autoritetit Kontraktues për të garantuar sigurinë gjatë punëve me azbest është i ligjshëm dhe i arsyeshëm, mirëpo mënyra e zgjedhur për arritjen e këtij qëllimi nuk është proporcionale, pasi eliminon operatorët ekonomikë për shkak të mungesës së një licence që nuk ekziston. Kërkesat e prokurimit duhet të matin aftësinë reale të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës dhe jo posedimin e dokumenteve administrative të pamundura për t'u siguruar.

5. Praktika e autoriteteve të tjera kontraktuese konfirmon se një licencë e tillë nuk ekziston

Për më tepër, pretendimi i Autoritetit Kontraktues se kërkesa për posedimin e një licence apo

pëlqimi për trajtimin e azbestit është e arsyeshme dhe në përputhje me standardet evropiane, bie në kundërshtim me praktikën e institucioneve të tjera publike në Republikën e Kosovës, të cilat kanë konstatuar se një mekanizëm i tillë licencimi aktualisht nuk ekziston.

Praktika 1 - Agjencia Qendrore e Prokurimit

Konkretisht, **Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP)**, gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit **"Heqja e Azbestit nga lokacioni i FKPK-së"** në gusht 2025, kishte përcaktuar fillimisht kërkesën që:

"Operatori Ekonomik (OE) duhet të ketë leje/licencë përkatëse nga institucioni përkatës i Kosovës për heqjen, grumbullimin dhe trajtimin e azbestit."

Pas kërkesave për sqarime dhe shqyrtimit të çështjes, AQP ka bërë korrigjimin e Dosjes së Tenderit dhe e ka larguar këtë kërkesë, duke deklaruar:

"Megenëse një licencë e tillë nuk lëshohet nga institucionet e Republikës së Kosovës, kjo kërkesë me anë të korrigjimit do të hiqet nga kërkesat për këtë aktivitet."

Ky qëndrim i AQP-së është veçanërisht i rëndësishëm, pasi AQP është institucion publik përgjegjës për zhvillimin e procedurave të centralizuara të prokurimit dhe për zbatimin e rregullave të prokurimit publik. Përmes këtij korrigjimi, vetë një autoritet publik ka pranuar faktin se kërkesa për një licencë të tillë nuk ka bazë praktike dhe nuk mund të përdoret si kriter kualifikimi.

Prandaj, në rrethanat kur institucionet publike kanë konstatuar se një licencë e tillë nuk lëshohet në Republikën e Kosovës, vendosja e të njëjtit kriter nga Autoriteti Kontraktues në këtë procedurë përbën një kërkesë të pamundur për t'u përmbushur dhe cenon parimet e konkurrencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë një dokument që vetë institucionet publike kanë pranuar se nuk ekziston në praktikën administrative të Republikës së Kosovës. Përgjigje në kërkesat për sqarime shtesë -18 07 2025 bashkangjitur.

https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciForm.aspx?id=3715344

Praktika 2 – Komuna Hani i Elezit

Gjithashtu, në **tetor 2025**, Komuna e Hanit të Elezit ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit **"Demolimi i lokaleve (me përmbajtje azbesti) në rr. Dëshmorët e Kombit – Hani i Elezit"**, ku në Dosjen e Tenderit ishte kërkuar:

"Licencë valide ose leja përkatëse mjedisore e lëshuar nga MMP/III sipas Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat."

Megjithatë, kjo kërkesë rezultoi e pamundur për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë dhe, si pasojë, Autoriteti Kontraktues e anuloi aktivitetin e prokurimit, pasi asnjë operator

ekonomik nuk kishte arritur të plotësonte këtë kusht.

Ky rast demonstroi në mënyrë konkrete se vendosja e kërkesave për licenca të tilla, pa ekzistuar një bazë ligjore dhe institucion që i lëshon ato, nuk siguron konkurrencë dhe nuk garanton për zgjedhjen e operatorëve më të aftë, por përkundrazi krijon pengesë absolute për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë. Formulimi B58 Njoftimi mbi vendimin e AK i bashkangjitur.

<https://e-prokurimi.rks->

[gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=3838760](https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=3838760)

6. Shkelja e nenit 44 të LPP-së

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë më datë **20.07.2026**, ndërsa ka përcaktuar hapjen e ofertave më datë **29.07.2026**, duke lënë vetëm nentë (9) ditë për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave. Një afat i tillë është në kundërshtim me nenin 44 paragrafi 2.2 të LPP-së, i cili përcakton se, për kontratat që nuk janë kontrata publike me vlerë të madhe, afati minimal për pranimin e ofertave duhet të jetë **jo më pak se njëzet (20) ditë**.

9. Dëmet materiale

Përkrahja mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkakuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktues për posedimin e "Licencës apo pëlqimit nga Ministria për trajtimin e azbestit" i shkakton dëm material Operatorit Ekonomik, pasi krijon pamundësi objektive për të përmbushur kërkesat e tenderit për shkak të mungesës së një dokumenti i cili nuk lëshohet nga asnjë autoritet kompetent në Republikën e Kosovës. Për pasojë, Operatori Ekonomik rrezikon të përjashtohet nga procedura jo për shkak të mungesës së kapaciteteve profesionale apo teknike, por vetëm për shkak të një kriteri administrativ të pazbatueshëm.

Duke u bazuar në nenet përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik, kërkojmë nga OSHP që:

1. Të aprovojë këtë kërkesë si të bazuar.
2. Të konstatojë se kriteri: "Licencë apo pëlqim nga Ministria për trajtimin e azbestit" është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, pasi kërkon një dokument që nuk parashikohet nga legjislacioni në fuqi dhe nuk lëshohet nga autoritetet kompetente në Republikën e Kosovës.
3. Të korrigjojë Dosjen e Tenderit duke larguar këtë kriter dhe duke vendosur një kërkesë proporcionale dhe të zbatueshme, e cila garanton kompetencën profesionale pa kufizuar konkurrencën.
4. Të zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave pas publikimit të korrigjimit të Dosjes së Tenderit, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësi të barabartë për pjesëmarrje në procedurë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. një kopje e Njoftimit mbi kontratë
2. një kopje e Kërkeses për rishqyrtim
3. një kopje të vendimit të AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
4. Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
5. **Përgjigje në kërkesat për sqarime shtesë -18 07 2025 – AQP**
6. **B58 Vendimi i AK – 10.09.2025 – Hani i Elezit**

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*